VENDIM
Nr. 28, datë 25.6.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare e " "
Fatmir Hoxha	Anëtar i " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "

me sekretare Blerina Basha, në datën 7.2.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 50/23 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Liljana Selishta

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja, në cilësinë e paditëses, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadinë me objekt "Pjesëtimin e sendit të përbashkët". Me vendimin nr. 3877, datë 2.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lejimin e pjesëtimit të sendit të përbashkët, duke i takuar kërkueses 4/20 pjesë ideale në natyrë.

2. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 259, datë 10.9.2009, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për vazhdimin e gjykimit të çështjes (fazës së dytë të pjesëtimit). Kancelaria e gjykatës e ka bërë me dije kërkuesen se dosja është dërguar për shqyrtim rekursi në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës, duke filluar nga momenti i depozitimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (25.6.2012) e deri në momentin e marrjes në shqyrtim të saj nga kjo gjykatë (20.11.2012), Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2215, datë 23.10.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të depozituar në datën 28.10.2009. Sipas rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, disa lloje çështjesh, si pasojë e afateve të shkurtra për gjykim, parashikuar nga legjislacioni në fuqi, apo nevojës për vazhdimin e gjykimit në shkallët e tjera, shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Ndër rastet kur Gjykata e Lartë vepron me procedurë të përshpejtuar, përfshihen edhe çështjet e pjesëtimit të pasurisë (faza e parë).

3. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ajo ka argumentuar se kanë kaluar katër vjet nga momenti i depozitimit të padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (28.1.2008) dhe ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor i fazës së dytë të pjesëtimit. Sipas kërkueses, edhe pse dosja ndodhej në Gjykatën e Lartë për shqyrtim rekursi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhej të vazhdonte me fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë. Bazuar në nenin 451 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vendimi nr. 3877, datë 2.12.2008 i Gjykatës së Rrethit Tiranë konsiderohet vendim i formës së prerë dhe, sipas

nenit 371 të KPC-së, kur vendimi i ndërmjetëm ka marrë formë të prerë, gjykata vazhdon me gjykimin në fazën e dytë.

4. ***Subjekti i interesuar***, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, në parashtrimet me shkrim ka pretenduar se:

4.1 Sipas KPC-së, ndaj vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të sendeve në bashkëpronësi, lejohet ankim i veçantë i cili pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit. Ndaj, me të drejtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dërguar dosjen në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka vazhduar me fazën e dytë të pjesëtimit;

4.2 Vendimi gjyqësor i Gjykatës së Apelit Tiranë, në rastin konkret, nuk është i formës së prerë, pasi në kuadrin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe legjislacionit procedural civil, një vendim quhet i formës së prerë vetëm kur është ezauruar gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastet e paraqitjes së rekursit;

4.3 Pretendimet e kërkueses janë të paargumentuara dhe të pambështetura në fakte dhe për këto arsye duhet të deklarohen haptazi të pabazuara.

II
Vlerësimi i Gjykatës

Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

5. Kërkuesja ka argumentuar se mosvazhdimi i gjykimit të çështjes me fazën e dytë të pjesëtimit ka sjellë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo ka pretenduar se mosvazhdimi i gjykimit për një kohë të gjatë, duke filluar nga nxjerrja e vendimit nr. 259, datë 10.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka penguar realizimin e të drejtave të saj pasurore.

6. Gjykata, gjatë votimit të çështjes mbi këtë pretendim, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë[1], nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/1 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ka konkluduar se kjo kërkesë e kërkueses duhet të refuzohet. Sipas këtij neni, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesja të riparaqesë kërkesën, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, germa "a" dhe nenit 134, pika 1, germa "f" të Kushtetutës; nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

[1] Votuan për pranimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Sokol Berberi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.